



Viti i VIII-të i Botimit, Nr.1,
Korrik 2017

MBI FILLESAT E ARSIMIT DYGJUHËSH NË SHQIPËRI

Elida Begaj

Departamenti i lëndëve paraklinike, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Tiranë

Adresë kontakti: begaj.elda@yahoo.com

Përmbledhje

Në fokus të këtij punimi janë disa të dhëna të ndeshura në dorëshkrime dhe disa modele shollash në të cilat mësimet janë dhënë në më shumë se në një gjuhë. E veçanta e këtij modeli shkollash është e formimi i tyre, nisur nga qëllime fetare dhe që në përbërje kanë nxënës që kanë shqipen si gjuhë amtare.

Punimi synon të bëjë një renditje kronologjike të shkollave në fjalë. Në këto shkolla është përdorur italishtja dhe shqipja krahas gjuhës latine. Janë vjelë të dhëna prej modele shkollash të cilat, edhe pse janë formuar për qëllime fetare, në përbërje përfshijnë nxënës që e kanë shqipen si gjuhë amtare. Italishtja apo gjuhët e tjera janë mësuar si gjuhë të huaja në nisje të ciklit mësimor e më pas është vazhduar me modelet shkollash të cilat e kanë konsideruar mësimin e gjuhës së dytë jo thjesht si njohuri gjuhësore, por si çelës për të zhvilluar të njëjtën trajtesë mësimore në gjuhën shqipe dhe në gjuhët e tjera. Gjurmët e para të këtij modeli shkollimi i hasim prej viti 1629 në Lezhë, të dhënat pasurohen edhe me shkolla të tjera jashtë kufijve, edhe pse në fillimet e tyre këto shkolla lidhen tërësisht me qëllime fetare, siç ishte kolegji i Shën Adrianit.

Fjalë kyçe: *dëshmi, gjuhë amtare, gjuhë e huaj, arsim dygjuhësh, religjion,*

THE BEGINING OF ALBANIAN BILINGUAL EDUCATION

Abstract

In this research I have looked at some old school models in which education was developed in a different form. For example, Italian and Albanian language were used in addition to Latin. For all the students Albanian was their native language. Italian was a foreign language to them. These schools were founded for religious purposes, but after a short period of time these methods were considered not only a key for learning a second language, but were viewed as a new teaching approach. I have studied some models of education in these schools from 1629 until model of Saint Adrian College.

Key words: *evidence, mother tongue, foreign language, bilingual, education, religion.*

Fillesat e arsimit dygjuhësh, dëshmi nga Lezha

Emri i Benedetto Orsinit lidhet me dëshmitë për hapjen e një shkolle dygjuhëshe në dioqezën e Lezhës në vitin 1629. Kjo dëshmi identifikohet në një relacion të dërguar Propagandës Fide në Romë (A. Prop. Fide, F. SRCG 262, fl. 167). Në të bëhet fjalë për zonën fushore të dioqezës së tij, të cilën e cilëson si “zonë e nënshtruar turqve”, ndërsa zona tjetër e asaj ane, “malorja”, ishte “armike” e tyre. Ipeshkvi raguzian i Lezhës, B. Orsin, shkruan se “ka shumë të rinj, të cilët mësojnë këndim e shkrim, por që, deri tani, nuk janë klerikuar” (s’janë bërë ende Xhako, s’i janë destinuar karrierës kishtare). Kjo përmbajtje lidhet me relacionin e 1402-3 të dërguar prej tij. Orsini nuk na thotë se ku jepej mësimi. Ai përmend fshatin Zojmen, të zonës fushore, përmend edhe Rubigun e Velën, të asaj ane malore. Mundej që mësimi bëhej në Zojmen, po më shumë në Pëdhanën (Pllana) pranë, ku do të sigurohemi se më pas ka shkollë dhe që ishte qendra më e rëndësishme kishtare aty, mbi lumin e Matit. Gjatë shek. XVII, shkollë ka pasur dhe në Velë e në Blinisht. Si gjuhë e mësimi ishte italishtja, të cilën nxënësit e përvetësonin me anë të shqipes, asoherë, sigurisht, me anë të librave që kishte botuar Pjetër Budi (1618-21), por dhe me ndonjë tekst shqip të panjohur të krijuar nga ndonjë klerik tjetër. Mësohej dhe latinishtja që ishte gjuhë e kultit (1).

Një tjetër shkollë e përfshirë në këtë kronologji është edhe një shkollë në Blinisht të Lezhës. Daton nga viti 1639- 1648. Kjo shkollë mendohet se kishte se kishte 59 nxënës. Mësimi zhvillohej në “vernacula lingua”, apo “gjuhë e vendit”. Në atë kohë quhej italishtja përkrah latinishtes. Në këtë rast, është menduar se shqipja, sidoqoftë, duhet të ketë shërbyer për të mësuar italishten dhe latinishten. Mësues mendohet të ketë qenë Cherubino della Vallebona. Si tekste, nxënësit shqiptarë mund të kenë pasur, për gjuhën shqipe, veprat e Pjetër Budit e të Frang Bardhit, të botuara në vitet 1618-36 (1).

Shkolla e Lezhës daton në vitin 1703 dhe për të dimë se flitet në Aktet e Kuvendit të Arbërit, të botuar në 1706 në Romë, “Koncilli provinciali” 108, të cilët e rekomandojnë si botim për shkollat e Kurbinut e të Lezhës, duke përfshirë edhe mësimin e latinishtes me anë të shqipes, dhe jo vetëm për njohjen e vendimeve që mori Kuvendi për administrimin e kishës katolike ndër ne (“Scolese curbinut e te Lesciese”). Kjo shkollë është një dëshmi e qartë se shqipja përdorej si gjuhë e shkruar në shkollë për nevojat e mësimi. Përbën ky fakt një tjetër dëshmi që si mjete didaktike këto ambiente shkollore shërbenin botimet e sipërpërmendura doktrinare, po gjithashtu të përfshira janë edhe tekstet e hartuara nga misionarët e huaj, si p.sh. Leo a Cittadella, autori i një Fjalori para vitit 1678 (1).

Institucione në gjuhën italiane dhe shqipe në Itali

Seminari italo- shqiptar i Palermos 1734, që prej fillimit ka pasur atributet dhe funksionet e një qendre filologjike italo – shqiptare dhe në veçanti të një qendre albanologjike, e cila mendohet se u ideua dhe u themelua nga At Giorgia Guzzeta dhe mendohet se kishte në përbërje të saj një grup të madh studentësh, ndjekës të tij, kolegë të përkushtuar në kërkimet në fushën e historisë, kulturës, dhe filologjisë italo-shqiptare si, Paolo Marria Parino, Nicolo Figlia, Nicolo Chetta, Giuseppe Crispi. Në fillim të shekullit XX, pjesë e këtij seminari bëhet edhe Paolo Skiroio, i cili kërkoi “të rizbulonte” kopjen e parë të “Mesharit” të Gjon Buzukut. Gjatë shekullit XVIII nuk ka ndonjë qendër të ngjashme studimore as në Europë, as në Ballkan që mund të konkurronte Seminarin Arbëresh të Palermos për aktivitetin e tij social- kulturor. Kështu p.sh., në gjysmën e dytë të shekullit XVIII në Ballkanin Perëndimor, edhe pse u themelua në një ambient kompakt etno-kulturor, shqipja përdorej si gjuhë gjysmë ndihmëse tek shqipfolësit për të mësuar më mirë greqishten, ndërsa në Veri, përveçse improvizimit të një shkolle ku fillestarët merrnin mësimet e

Katekizmit në gjuhën shqipe gjejmë vetëm iniciativave të pavarura (2).

Rëndësi merr Kolegji Arbëresh i Shën Adrianit në Shën Mitër Korone. Ai është konsideruar si institut ndërkombëtar italo-shqiptar. Është përfshirë në këtë punim dhe për arsye të kurrikulave që u arsyetuan të përfshiheshin në programet e kësaj shkolle.

Ky institucion i rëndësishëm nisi jetën në Shën Mitër Korone, një fshat arbëresh në provincën e Kozencës (Kalabri). Mendohet se funksioni i tij i tejkalon parimet institucionale që kishte pasur më herët kur ishte themeluar. Vit pas viti ai e zgjeroi qëllimin e tij duke mos u kufizuar vetëm te formimi i seminaristëve që përgatiteshin për një religjion të caktuar, por përfshinte edhe studentë që synonin vet formimin shkencor-kulturor dhe laik. Në fund të shekullit XIX, ky kolegji arriti të shndërrohej në kolegji ndërkombëtar për studentët që vinin jo vetëm nga troje arbëreshe por sidomos, por dhe studentë që vinin nga Shqipëria dhe nga Kosova.

Rruga drejt kolegjit

Në vitin 1470 një grup mërgimtarësh shqiptarë, ndoshta të udhëhequr nga Gjon Kastrioti Skënderbeu, i biri i Gjergj Kastriotit, pasi mbërritën në territorin kalabrez të Val di Crati, kërkuan nëse mund të strehoheshin në tokën që i përkiste manastirit grek të Shën-Adrianit. Marrëveshja e nënshkruar mes tyre dhe arkimandritit të Shën Adrianit citohet si dokumenti më i vjetër që njihet në arkivat e kësaj kishe për strehimin e popullsisë shqiptare. Në këtë marrëveshje, murgjit i konsiderojnë shqiptarët jo si të huaj, por u ofrohet “mbrojtje e çiltër dhe atërore”. Nga ana tjetër, është vënë re se shqiptarët preferonin të ishin në shërbim të etërve të kishës, jo vetëm se ishte më fisnikë, por sepse trajtimi që u ofrohej ishte shumë më i mirë. Ndërkohë, dhe shtrirja me banim në këtë territor bëhej dhe më e thjeshtë sepse elementi grek ishte akoma i gjallë e i fortë në këtë periudhë, duke përfaqësuar për shqiptarët një element të fortë vazhdimësie kulturore. Shën Adriani ishte ndër manastiret më të njohura italo-greke në Kalabri, dhe të gjitha ritet kryheshin zyrtarisht në gjuhën greke. Për shqiptarët këto rite ishin të afërta edhe sepse ata i përkisnin në shumicën e tyre ritit ortodoks, pasi vinin kryesisht nga Jugu i Shqipërisë, të arratisur nga pushtimi turk që rrezikonte lirinë e tyre si individ, lirinë ekonomike, politike dhe sigurisht edhe atë fetare. Mendohet së nga pikëvështrimi arkitekturor dhe artistik, shqiptarëve u kujtonte ndërtimet e bukura religjioze të braktisura përtej detit (3).

Themelimi i Manastirit dhe kishës së Shën Adrianit daton rreth viteve 950-955, nga murgu i njohur kalabrez i ritit grek, Nilo nga Rosano, i cili më pas u bë dhe themelues i manastirit të Grottaferratas pranë Romës. Sot nga ky manastir ka mbetur vetëm kisha, e cila thuajse është e mbuluar nga godinat e kolegjit italo-grek, i cili në vitin 1794 u transferua në S. Demetrio Corone nga S. Benedetto Ullano, në të cilin më parë nga Papa Klementi XII në vitin 1732 ishte ngritur një institut klerikal për rininë arbëreshe.


Dokumente që mbështesin historinë e kolegjit Shën Adrianit i gjejmë dhe në fondin e Jeronim De Radës pranë AQSH-së. Një botim i tipografisë Monteleone e tregon themelimin e kolegjit të Shën Benedeto Ullano (4). Në këtë botim lexojmë si në vijim:


“Midis shekujve të pesëmbëdhjetë e të gjashtëmbëdhjetë shumë familje shqiptare dhe epirote braktisën për arsye politike vendlindjet e tyre dhe u strehuan në Mbretërinë e Napolit, veçanërisht në Kalabri, ku u pritën në kohën e mbretit Alfonsi i Aragonës, Ferdinando i Parë e Carlo i Pestë. Fati u priu në fillim, por më pas ata ranë në mjerim të thellë. Megjithatë, nuk munguan shpirtrat bujarë, të cilët vendosën që t’i çlironin këta njerëz nga varfëria e thellë dhe padija. Ata ishin vëllezërit Stefano, Maurizio dhe Felice Samuele Rodota’ dei Coronei të kolonisë shqiptare në S.

Benedetto Ullano. Sidomos ky i fundi(Felice), i cili u shkollua, u bë prift dhe jetonte në Romë nga viti 1700- 1730 në kohën e papëve Clemente XI, Innocenzo XIII, Benedetto XIII e Clemente XII, nuk i kurseu përpjekjet dhe sakrificat për të marrë nga Papa lejen për të themeluar dhe ndërtuar falas një institut që do të arsimonte shqiptarët dhe do të ndikonte në ruajtjen e ritit gerko-uniat që kishin marrë me vete nga toka mëmë.

Papa Klementi XII, nga familja Corsini e Firences, që nga nëna ishte me gjak shqiptar, duke marrë parasysh sa të vështirë e kishin shqiptarët të dërgonin djemtë e tyre në Kolegjin e Shën Thanasit në Romë për t'u shkolluar për klerikë, pranoi më në fund me dashamirësi kërkesat e përsëritura të të Përndriturit Felice Samuele Rodotà dhe me bulat (dekretet papnore) e 11 tetorit 1732, të 1 korrikut 1734 dhe të 19 prillit 1735 themeloi, pajisi e regulloi, sipas normave të disiplinës për italo-grekët (nënshetësat italianë të ritit grek ortodoks), një kolegji në Shën Benedeto Ulano, në një manastir të vjetër të benediktinëve, i cili u quajt Corsini nga familja e themeluesit, duke dhuruar një shumë prej 12 mijë skudash romane, të caktuara për blerjen e pronave të patundshme. [...]

Kolegji, edhe pse si qëllim parësor kishte të edukonte falas nxënësit për të krijuar priftërinj më të gjithëdijshëm në kolonitë shqiptare, me vullnetin e Themeluesit priti si konviktorë edhe studentë laikë që donin të merrnin një edukim thjesht qytetar me një pagesë modeste prej 102 lira në vit; pra që prej fillimit pati natyrë të përzier kishtarë-laike. Në vijim janë bashkëngjitur fletët 18-19 së dosjes 7, të fondit personal të Je De Radës. Më poshtë po bashkëngjisim dokumentin origjinal të gjendur në arkiv.






Ky kolegji kaloi pranë manastirit të Shën Adrianit në vitin 1794 në Shën Mitër Korone. Fillimisht, mësimi zhvillohej në gjuhën greke, por krahas saj filloi të mësohej dhe gjuha latine. Vite më vonë do të bëhej italishtja gjuha mësimi, ndërsa gjuha shqipe do të përdorej në për të komunikuar nxënësit mes tyre. Shqipja filloi të përdorej krahas gjuhëve të tjera falë përpjekjeve të arbëreshëve, dhe në veçanti të De Radës. Në vitin 1849 ata themelojnë Katedrën e Gjuhës Shqipe të krahasuar, e cila iu besua De Radës, që në atë kohë ishte 35vjeç. Në orët mësimore u përfshi dhe mësimi i shqipes dhe mësuesi i parë i nxënësve shqiptar ishte Jeronim de Rada, i konsideruar kështu si mësuesi i parë i shkollës me karakter laik (5). Instituti u mbyll në vitin 1852, por me përpjekje të De Radës u riçel në vitin 1889. Ky kolegji kaloi pranë manastirit të Shën Adrianit në vitin 1794 në Shën Mitër Korone. Letërkëmbimet mes personaliteteve të këtij kolegji, tematikat e seminareve, kërkesat, emërimet apo përpjekjet për hapjen e një katedre së gjuhës shqipe, i gjejmë në fondin e Jeronin De Radës pranë Arkivit Qendror të Shtetit. Materialet e dosjeve të këtij fondi përmbajnë informacione rreth këtij kolegji që nga periudha kur ai njihej si kolegji italo – grek, si u përfshi aty popullsia arbëreshe, letra falënderimi të personaliteteve, dispozitat e përgjithshme, fjalimet e De Radës në kohën kur ishte drejtues shkollë, lista e librave në gjuhë shqipe dhe në gjuhë thuaj që gjendeshin në atë periudhë në bibliotekën e këtij kolegji. Nga letërkëmbimet veçojmë një letër falënderimi të nënshkruar Battista Canale.

Në krye të fletës është logoja e Kolegjit italo-grek të Shën Adrianit, dhe mban datën 17 tetor 1890, e nënshkruar nga Battista Canale, i cili përcjell nderimet dhe falënderimet e tij për punën e kryer nga ky kolegji. Citojmë: “Jam i nderuar të marr pjesë në S. A. (Shën Adrian) në emër të Monsignor Ipeshkvit Presidentit (Drejtorit) të kolegjit të Shën Adrianos Imzot Vejcevo, që është Presidenti i drejtorisë së këtij gjimnazi i cili ka inteligjencën për të furnizuar profesorët në të mësuarit e gjuhës franceze dhe mbajtjen e konferencave filologjike krahasuese të gjuhës greko-latine- abanese (shqipe). Bilanci është ende i papërfunduar dhe nuk mund të na japë ende asnjë të dhënë për shpërblimin që i afrohet këtij kolegji i cili nuk ka hartuar ende preventivin për vitin shkollor 1890- 1891 i cili do të fillojë me 1 Nëntor.

Ju afrojmë ndjenjat e sinqerta të shpirtit” (7). Në vijim po paraqesim dorëshkrimin origjinal të kësaj letre.



Teksti i kësaj letre është me shkrim dore dhe në gjuhën italiane. Përmbajtja e cituar i drejtohet Jeronim de Radës, Drejtorit të Kolegjit në atë periudhë. Përshkrimi i zhvillimit të konferencave filologjike që kanë në fokus krahasimin e gjuhëve të vjetra duke përfshirë dhe gjuhën shqipe, të drejton kah idesë se shqipja është mësuar, folur dhe praktikuar prej nxënësve krahas dy gjuhëve të tjera të sipërpërmendura. Edhe pse ky fakt citohet nga një letër falënderimi, dëshmon se gjuha shqipe është mësuar me të drejta të barabarta krahas gjuhëve të tjera. Mund të pohojmë se kolegji arbëresh i pasur me një rit fetar dhe traditë kulturore të veçantë, brenda kishës katolike ka qenë i vetmi kolegji në Mbretërinë e Napolit që diti të bashkonte nevojat fetare të studentëve që përgatiteshin për t'u shuguruar priftërinj me nevojat e studentëve që studionin për t'u përgatitur për

jetën civile, si profesionistë në fushat e ndryshme, profesorë, avokatë, mjekë, gjyqtarë, politikanë, etj. Me të drejtë në kurset studimore parashikonin aq lëndë klasike dhe shkencore, sa edhe lëndë me karakter fetar, siç është teologjia, filozofia, liturgjia, historia e kishës, këndimi liturgjik etj. Edhe revista “Fjamuri i Arbrit” (1830-1887) u shkrua njëkohësisht në dy gjuhë dhe për një kohë të gjatë ndau në shkrime, idetë dhe qëllimet që mbruheshin dhe që piqeshin në Kolegj nga bota shqiptare, duke ilustruar më së mirë idenë e funksionimit të kolegjit si një institut ndërkombëtar italo – shqiptar. Veprimtaria e De Radës në revistën “Fjamuri Arbrit” (1883- 1887), një revistë dygjuhëshe, arbërisht dhe italisht, tregon gjendjen e arbëreshëve që u përkasin dy kombeve, atij arbëresh dhe atij italian.

Veprimtaria arsimore e jezuitëve

Një veprimtari të gjallë kulturore e arsimore zhvilluan jezuitët në Shqipëri, për aq kohë sa qëndruan në këtë vend. Ndër veprimtaritë kulturore përmendim ngritjen e shtypshkronjës së parë, botimin e revistës së parë “Elçija e Zemrës së Krishtit”, krijimin e bandës së parë muzikore e të orkestrave moderne, fillimin e artit dramatik, lulëzimin e shoqërive kulturore, patriotike e sportive, mbledhjen e koleksionit të famshëm numizmatik, hapjen e muzeut botanik, etnografik, etj., etj.

Jezuitët u thirrën në Shkodër në vitin 1841 për të themeluar një seminar për priftërinj laikë. Në fillim hapën një shkollë fillore me tri klasa për fëmijë që nga mosha nëntëvjeçare. Në shkollë përdorej gjuha shqipe si ndërmjetëse për mësimin e italishtes. Mbas disa përpjekjesh për riaktivizimin e seminarit të priftërinjve, më në fund u hap një kolegj kushtuar Shën Françesk Saverit, i njohur me emrin popullor Kolegji Saverian. Kolegji ofronte një arsim të plotë e të rregullt, me programe të studiuara e të zgjedhura, me metoda të përparura e efikase, me mjete moderne e të reja. Shkolla në fillim pati drejtim tregtar, më vonë mori drejtim klasik, por gjithmonë që e barasvlershme me shkollat më të mira të mesme të Evropës Perëndimore. Gjuha e mësimin në këtë kolegj ishte vetëm italishtja. Gjuha shqipe, historia e letërsia e saj ishin përjashtuar nga programi mësimor. Kjo ishte edhe një arsye pse jezuitët shpeshherë nuk shiheshin me sy të mirë në Shqipërinë e Veriut. Kjo ide përforcohet nëse shikojmë raportin e konsullit Ippen në 14 korrik 1898 (7). Gjuha shqipe u fut si lëndë më vonë, në vitin 1911 me 5 orë në javë, ndërkohë që të gjitha lëndët bëheshin në gjuhën italiane. Kolegji Saverian u mbyll nga shteti komunist në vitin 1946.

Në vitin 1992, pas rënies së regjimit komunist, jezuitët u kthyen përsëri në Shqipëri dhe hapën në Shkodër një shkollë, e cila në vitin 1995 mori emrin Atë Pjetër Meshkalla, një jezuit shkodran.

Diskutime

Përshkrimi i zhvillimit të konferencave filologjike të fokusuar në krahasimin e gjuhëve të vjetra duke përfshirë dhe gjuhën shqipe, të drejton kah idesë se shqipja është mësuar, folur dhe praktikuar prej nxënësve krahas dy gjuhëve të tjera të sipërpërmendura duke na sjellë ekzistencën e një modeli arsimit dygjuhësh.

Shtrojmë pyetjen: A ka pasur modele të ngjashme të këtyre shkollave në vitet në vazhdim? Nëse po, cili ka qenë qëllimi i tyre? A janë konsideruar modele të suksesshme që kanë jetëgjatësi dhe vazhdimësi apo kanë mbetur vetëm gjurmë të këtyre shkollave?

Përfundime

Gjurmët e para të modeli të shkollimit dygjuhësh i hasim prej viti 1629 në Lezhë, e pasuar nga shkolla të tjera jashtë kufijve. Në fillimet e tyre këto shkolla lidhen tërësisht me qëllime fetare,

siç ishte kolegji i Shën Adrianit. Sipas literaturës së konsultuar, në këto shkolla supozohet të jetë përdorur shqipja krahas italishtes dhe latinishtes, ndërkohë që tekstet kishtarë që duhet të kenë shërbyer në praktikën shkollore, mund të kenë qenë të autorëve veriorë Pjetër Budi dhe Frang Bardhi. Ky supozim vjen nga fakti që mbeten të njohura dhe sot e kësaj dite pikërisht përpilimet e këtyre të fundit, me një veprimtari që duhet të jetë lëvruar në periudhën 1618-1636.

Është e rëndësishme të vihet në dukje se italishtja apo gjuhët e tjera janë mësuar si gjuhë të huaja në nisje të ciklit mësimor. Më pas është vazhduar me modelet shkollash të cilat e kanë konsideruar mësimin e gjuhës së dytë jo thjesht si njohuri gjuhësore, por si çelës për të zhvilluar të njëjtën trajtesë mësimore në gjuhën shqipe dhe në gjuhët e tjera.

Referenca

1. Shuteriqi, Dh. S. (2005). *Tekstet shqipe dhe shkrimi i shqipes në vitet 879-1800*, f. 195.
2. Demiraj, B. (2007). *Giorgio Guzzetta e le origini della filologia italo- Albanese*. International Journal of Diachronic Linguistics and Linguistics Reconstructions. F. 64- 65.
3. Martino, C. (2007). “S. Demetrio Corone” *Il Monastero di S. Adriano e gli Arbëreshë*. Besa – Fede/ Roma , f. 2- 3.
4. Fondi 24, Dosja 53, fl 18, 19A.Q.SH. Të dhënat janë të Tipografisë Monteleone (Tipografia Passafaro) nell’ Orfanotrofo Provialio e në botimin Memoria “COLLEGIO ITALO GRECO CORSINI DI SANT’ ADRIANO IN S. Demetrio CORONE (PROVINCIA DI COZENCA).
5. Koliqi, H. (2001). *Historia e arsimit shqiptar*. f,159, 253.
6. Fondi 24, Dosja 7, fl. 11.
7. E. Deusch, *Das k (u) k. Kultusprotektorat im albanischen Siedlungsgebiet*, Böhlau, Wien-Köln-Weimar, 2009, f. 485 v.



**SHKENCAT
E APLIKUARA
DHE
EKONOMIKE**

SEKSIONI 3

